URDHËR
Nr. 147, datë 1.8.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, znj. Romina Kuko, nga data 16.8.2022 deri më datë 22.8.2022.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm znj. Romina Kuko.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi